



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA SKENDERAJ
ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKENDERAJ
SKENDERAJ
Nr. 01-060/01-0018683/25
Data 20.05.2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2 dhe neni 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 pika 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385, i dt.03.12.2008, si dhe neni 5 Rregullores së Punë se Kuvendit, si dhe ne pajtim me rregullat e procedurës për mbajtjen e mbledhjeve, Kryesuesja e kuvendit, znj. Adelina Spahiu:

THËRRET

Mbledhjen e Rregullt të Kuvendit Komunal të Skenderaj, e cila do të mbahet me datë 29.05.2025, (ditë e enjte), me fillim prej orën 10:00, në Sallën e Kuvendit

Mbledhja do të ketë këtë:
REND DITE

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Propozim-vendim për bartjen e mjeteve të pashpenzuara të te hyrave vetanake nga viti 2024, për shpenzim për vitin 2025, me Nr.02-400/01-0017493/25, i datës 13.05.2025, (Raporton Drejtori i DBF-së, z. Ismet Aliu);
5. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme.



KRYESUESJA E KUVENDIT
znj. Adelina Spahiu



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL / ASSEMBLY OF MUNICIPALITY / SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ
Nr. 01.060/01-0018689/25
Data 20-05-2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverbali i MBLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL SKENDERAJ,
i datës 29.04.2025, ora 10:00

Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Vendimi i KQZ-së, për zëvendësimin e anëtares znj.Sala Jashari, me anëtares e kuvendit të Skenderajt znj.Egzona Geci, si dhe dhënia e betimit, (Raporton Kryesuesja e kuvendit, **znj.Adelina Spahiu**);
5. Shqyrtimi i Raportit financiar tremujor Janar-Mars 2025, me Nr.02-052/01-0013412/25, i datës 11.04.2025, (Raporton Drejtori i DBF-së, **z. Ismet Aliu**);
6. Propozim-vendim për ngritjen e tarifës së shërbimit për grumbullimin e mbeturinave të ofruara nga KRM, "UNITETI", Sh.A. Mitrovicë, (Ndryshimin dhe plotësimin e nenit 18 paragrafi 1.1 shtojca A, të Rregullores Nr.01-110/04-0005958/23, të datës 31.01.2023 për Menaxhimin e Mbeturinave të Komunës së Skenderajt), me Nr.02-352/01-0010872/25, të datës 24.03.2025, (Raporton U.d. i Kryeshefit ekzekutiv KRM "Uniteti" Sh. A. **z.Ylber Murtezaj**),
7. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme.

Kryesuesja e kuvendit, Adelina Spahiu: Të nderuar anëtar të kuvendit, drejtor të drejtorive, dhe gjithë ju të pranishëm, shkojmë në konstatime të kuorumit, në sallë janë 29 anëtar, mungojnë me arsye Dardan Shala dhe Ragip Durmishi.

-Shkojmë me miratimin e rendit të ditës, e hap debatin, nëse nuk ka, shkojmë në votim; Konstatohet me (21) vota për, (0) kundër dhe (2) abstenim, miratohet Rendi ditës.

Vazhdojmë me piken 3 të rendit të ditës,

-Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara, e hap debatin, nëse nuk ka shkojmë në votim; Konstatohet me (29) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Vazhdojmë me piken 4 të rendit të ditës;

-Vendimi i KQZ-së, për zëvendësimin e anëtares znj.Sala Jashari, me anëtares e kuvendit të Skenderajt znj. Egzona Geci, si dhe dhënia e betimit, (Raporton)

Kryesuesja e kuvendit, Adelina Spahiu; znj.Egzona Geci emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Skenderaj, nga subjekti politik "Lista e Pavarur Bekim Jashari "IDEAL" duke e zëvendësuar anëtares e Kuvendit Komunal znj. Sala Jashari, po nga i njëjti subjekt politik, e ftoj znj. Egzona Gecin të lexoj betimin;

Egzona Geci-IDEAL: Unë, (Egzona Geci) "betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e

mija si anëtare e Kuvendit të Komunës së Skenderajt, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

Kryesuesja: Faleminderit, Urime Egzona, vazhdojmë me pikën 5 të rendit ditës;

-Shqyrtimi i Raportit financiar tremujor Janar-Mars 2025, me Nr.02-052/01-0013412/25, i datës 11.04.2025, (Raporton);

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu: Fjala përshëndetëse, para vetes e keni Raportit financiar tremujor Janar-Mars 2025, është raporti i parë për këtë vit të hartuar sipas legjislacionit në fuqi. Komuna jonë në menaxhim për këtë vit të ka 19,881,471.00€, i shpenzuar në këtë tre muajor në 25.65%, në Paga dhe shtesa 25.48%, Mallra dhe shërbime 30.64%, Shërbime komunale 30.84%, Subvencione 24.56% dhe Shpenzime kapitale 22.89%. Pjesë e buxhetit janë edhe të hyrat vetanake në shumë prej 1,709,466.00€, dhe janë realizuar në këtë periudhë 20.79%. Llojet e shpenzimeve i kemi në faqen 8, me vendime gjyqësor përmes përmbaruesit privat janë marr 122,004.96€, dhe në fund i kemi shpenzimet e drejtorive zyrave neper të gjitha nën kodet, raportin e keni pas para vetes me kohe kush ka pyetje, jam këtu për përgjigje.

Kryesuesja: E hap debatin, fjalën ja kaloj;

Afrim Kabashi-NSD: Fjala përshëndetëse, Drejtor a ka mundësi me na informua tek shpenzimet buxhetore-lloji i shpenzimeve sipas kategorive dhe nën kodeve; Tek kodi 11411 Shtesa e veçantë për të zgjedhurit, për dy vitet paraprake zero shpenzime, në këtë vit në këtë tremujor shpenzime 17,139.38€? Tek kodi 11211 përvoja e punës shpenzime 109,674.87€? Tek kodi 13450 shërbimet e shtypjes dhe printimit një rritje e lartë në krahasim me dy vitet paraprake, për këtë tremujor shpenzim 19,865.40€? Tek kodi 14050 mirëmbajtja e mobilëve dhe pajisjeve shpenzime enorme në krahasim me vitet e kaluara, shpenzimi për këtë tremujor 65,983.50€? Tek kodi 14060 mirëmbajtje rutinore shpenzime të krijuara 66,732.47€, duke i bërë krahasimet me vitet e kaluara në periudhën e njëjtte një rritje e lartë? Andaj ju pyes drejtor a ka mundësi të na jepni detaje shtesë për shpenzime të krijuara të lartcekura? Si dhe a mund të na e konfirmoni nëse auditoret kanë filluar në procesin e auditimit për raportin e Komunës Skenderajt për vitin 2024, në rast se auditimi ka nisur do ta vlerësonim nëse mund të na informoni lidhur me përmbajtjen dhe gjetjet kryesore të deritanishme të raportit?, faleminderit.

Hysni Mehani-LVV: Fjala përshëndetëse, drejtor neve do pjesë të shpenzimeve na mungojnë të investimet kapitale, po ky raport i punës as puna juaj nuk ka nevojë të sfidohet nga opozita sepse mos punën tuaj po e sfidojnë këshilltaret tuaj karshi qeverisjes tuaj siç janë; ujëra të zeza, rrugë të paasfaltuara, mungesë ndriçimi, dhe as një hapë për rregullim të trafikut publik, deponi mbeturinave, janë disa prej ankesave që këshilltaret komunal të PDK-së, e kanë bërë, për këtë mbledhje dhe nuk kemi na çka me sfidua me shume as me thanë çka kanë thanë ata vetë.

Drejtor po me interesojnë disa sqarime tek tabela; nr. 5 fq.12 Të kategorisë; Mirëmbajtja e rrugëve lokale, Bujqësia 3,500€, Shëndetësia 3,400€, prej kur bujqësia dhe shëndetësia po merren me mirëmbajtjen e rrugëve lokale që e keni shënua ju në raport, a kanë sqarim? Tabela nr.5, fq.11, Zyra e kryetarit i ka kushtua buxhetit të komunës veç prej mallrave dhe shërbimeve 13,505.52€, pa i llogarit pagat 57,476.15€, prej 4,898,75€ janë dreka zyrtare, 2,654.70€ janë ushqime dhe pije. Pra gjithsej janë 7,545.00€ ushqim dhe pije për 64 ditë pune që d.m.th. çdo ditë pune zyra e kryetarit i ka kosto 120€ ushqim dhe pije, 30mijë€ janë dreka darka, ushqim dhe pije të shpenzuara për 3 muaj, 10mijë€ për një muaj për një komunë e vogël si e jona që janë tepër shume?

Të kategorisë, Sigurimet fizik të objekteve janë 72,246.72€, kjo kategori është një prej kategorive të përveqshme shpenzimeve me të mëdha për këta tre muaj edhe me rritjen me të madhe sepse në 2023 është zero, 2024 janë 31,624.32€, ndërsa në vitin 2025 janë 72,246.72€, për tre muaj. Na e dimë se këto 72,246.72€, janë paguar nipit të Sami Lushtakut që i bie diku 24mijë€ në muaj i kanë

kushtuar nipit të Sami Lushtakut, a na sqaron këtë drejtor, së na e dimë që kontrata është 400 mijë€, këta i kanë marrë për tre muaj 72,246.72€? Në fq.5 të raportit ju thoni së projektet kapitale marrin pjesë me 23.03% në buxhetin komunal, ndërsa në fq.7 të raportit ju thoni së marrim pjesë me 20.56% cila është e saktë sepse 2% në 15 milion është shume dallim i madh? Në fq.3 ju thoni së i keni paguar 253,004.96€ për vendimet gjyqësorë përmbartimore, ndërsa të tabela si të shpenzuara janë 122,004.96€, po ashtu ju thoni së kemi paguar kontratën kolektive për mësime dhe të tjera a mundesh me na tregua kush janë këta të tjera?

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu: Shtesa e veçantë për te zgjedhurit shuma 17,139.38€, këto shtesa kanë qenë edhe viteve të kaluara po me specifikim të planit kontabël është kërkuar që të ndahen së në këtë kategori bëjnë pjesë anëtarët e Kuvendit, KPF-së. Tek kodi 14050 mirëmbajtja e mobilëve dhe pajisjeve shuma 65,983.50€, këtu bëjnë pjesë, mirëmbajtja dhe servilizmi i nxemjeve qendrore në QKMF, furnizimi dhe mirëmbajtja e kamerave, mirëmbajtja e rëntgenit, mirëmbajtja e lifteve. Të mirëmbajtja rutinore, ky shpenzim është mirëmbajtja e kanalizimeve neper fshatra. Me vendime gjyqësore përmbartimore janë të sakta aty çka kam thënë 253,004.96€ dhe janë shpenzuar 122,004.96€, nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në vitin 2025. Të projektet kapitale janë shpenzuar 131,000.00€ nga disa projekte kapitale dhe këto dy shuma bëjnë 253,004.96€, që e përmende. Të bujqësia 3,500€ dhe shëndetësia 3,400€, ka ndodh së ka pas mungesë të mjeteve të një program dhe janë paguar nga një program tjetër, dhe janë paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve që nuk janë të ndaluara. Të furnizimi me ushqim dhe pije nuk janë dreka zyrtare të personave zyrtar ato janë për shtëpinë rezidenciale dhe çerdhen e fëmijëve, ndërsa Kompensimi i përfaqësimit brenda vendit janë dreka zyrtare ky është dallimi.

Kryesuesja: Dikush tjetër, nëse nuk ka, shkojmë në votim, Konstatojmë me (16) vota për, (11) kundër dhe (0) abstenim, përkrahet, Shqyrtimi i Raportit financiar tremujor Janar-Mars 2025, me Nr.02-052/01-0013412/25, i datës 11.04.2025.

Vazhdojmë me piken 6 të rendit ditës,

-Propozim-vendim për ngritjen e tarifës së shërbimit për grumbullimin e mbeturinave të ofruara nga KRM, "UNITETI", Sh.A. Mitrovicë, (Ndryshimin dhe plotësimin e nenit 18 paragrafi 1.1 shtojca A, të Rregullores Nr.01-110/04-0005958/23, të datës 31.01.2023 për Menaxhimin e Mbeturinave të Komunës së Skenderajt), Nr.02-352/01-0010872/25, të dt. 24.03.2025, (Raporton U.d. i Kryeshefit ekzekutiv KRM "Uniteti" Sh. A. Njësia Skenderajt);

Ylber Murtezaj: Fjala përshëndetëse, jam U.d. i Kryeshefit ekzekutiv KRM "Uniteti" Sh. A. Njësia Skenderajt, këtë pozitë e ushtroj prej tetorit të vitit 2024. Siç jeni në dijeni unë e kam bërë një kërkesë kryetarit për ngritjen e tarifës për shërbimit të mbeturinave prej 1€, dhe para vetes e keni kërkesën e arsyetuar në detaje. Kompania KRM, "UNITETI", Sh.A. Mitrovicë, mbijeton me vetë financim dhe të gjitha të hyrat e saj i krijon nga shërbimet të cilat i krijon nga dy komuna e Mitrovicës dhe e Skenderajt. Duke pas parasysh kohëve të fundit kemi pas një ngritje të çmimeve të naftit, vajrave, pjesëve rezervë të kamionëve që kanë ndikuar direkt në punën tonë si shpenzim financiar. Kemi kërkesë edhe nga punëtorët për ngritjen e pagës e cila them të drejtën nuk është e kënaqshme. Territori i komunës së Skenderajt është një territor shume i gjerë dhe mbledhja e mbeturinave po krijon shpenzime të mëdha, pastaj edhe deponia për hedhjen e mbeturinave është në Kushtovë diku 30km prej qytetit të Skenderajt, dhe po krijon shpenzim shtesë, dhe e kemi pa të arsyeshme me bë këtë kërkesë për ngritjen e tarifës në komunën e Skenderajt. Sipas një raporti që e ka bë një kompani private BK-Consulting të cilin e ka angazhuar dhe financuar Gizi Gjerman, shërbimi për grumbullimin e mbeturinave në Skenderajt ka qenë i përfshirë me 25%, po me përkushtimin e njësisë në Skenderajt sot kjo kompani është zgjeruar me 87.7% në territorin e administrativ të Skenderajt, gjithashtu me përkushtimin e kompanisë prej vitit 2018 kemi bë edhe

ngritjen e pagave me aq sa ka mundur kompania. Në tabele në material i keni të cekura së paga i një vozitësi në vitin 2018 ka qenë 280€ ndërsa sot është 428€, dhe 55€ i merr në emër të shujtave, punëtori fizik 233€, ndërsa sot i merr 382€, dhe 55€ i merr në emër të shujtave, Roja, sigurimi 233€, ndërsa sot 350€, dhe 55€ i merr në emër të shujtave. Dhe në fund është tabela e zërave financiare për periudhën e vitit 2024, dhe kërkoj nga ju që të përkrahni këtë rritje të tarifës, kush ka pyetje shtesë jam këtu për përgjigje.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Ali Lutfiu-PDK: Fjala përshëndetëse, drejtor desha me ju falënderua, është një menaxhim i mirë të paktën të lagjia ime ku jetoj, lidhje me rritjen e kësaj tarife prej 1€, jam interesuar të di kjo rritje a do ti përmisoj kushtet e punëtorëve fizik që çdo ditë jemi në kontakt me këta punëtorë dhe a do të kenë kushtet e duhura për punë të paktën të kenë këpuca, sepse mundet me i kushtua me shëndetin e tyre, përveç kushteve të punës sa do ti prek rritje e pagave kjo rritje e tarifës këta punëtorë?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Ylber Murtezaj: Sa i përket pajisjeve të punëtorëve me mjete të punës, ju njoftoj dhe ju garantoj së informatat nuk i keni të sakta, gjithë punëtoritë dy njësive në Mitrovicë e Skenderaj, muajnetor janë pajisur me uniforma dimëror, ndërsa javën e kaluar me 23 prill janë pajisur me uniforma dhe këpucë verore. Sa i përket ngritje së tarifës që keni kërkuar njësia në Skenderaj punon me humbje, mirëpo me rritjen e kësaj tarife kemi mendua për një ngritje të pagesë sa do solide për gjithë punëtorët fizik, garuzhdave, dhe vozitësit diku nga 50€.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Nasr Bajraktari-IDEAL: Fjala përshëndetëse, mirë se ke ardhur drejtor me vjen mirë që mbas 3 viteve që erdhe, edhe erdhe me një kërkesë për ngritjen e tarifës. Unë i kam disa pyetje: 1. Ku është raporti i auditori për vitin 2023-2024 për KRM UNITETI SH.A Mitrovicë pse nuk e keni sjellë këtë raport? 2. Pse nuk e keni sjellë listën e të gjithë punëtorëve të njësive në Skenderaj, me dite sa janë pagat për çdo punëtor? 3. Edhe vitin 2023 kur është bërë ngrita tarifës e keni përdor si pretekste rritjen e tarifës kinse rritjen e rritjen e pagave, ndërsa ende një pjesë të punëtorëve nuk jave keni rrit pagën? 4. Pse Elektricitetit të makinerisë z. Shaip Dibrani nuk ja keni rritë pagën sikurse punëtorëve tjerë ku qëndron problemi? 5. Pse punëtorët e operatives nuk kam uniforma, ku dihet se janë të rrezikuar në rrugë dhe nga infektimi gjatë punës, dhe uniformat i keni sjellë javën e kaluar, deri javën e kaluar nuk i keni sjellë? 6. Cila është gjendja e kamionëve të njësive, ku dihet se një numër i makinerisë edhe në cunga që rrinë po ju shpenzojnë naftë? 7. Ku është bageri njësive i blerë nga komuna në vitin 2021? 8. Sa kamionë i keni në teren dhe sa i keni funksion sot, ku ti i keni vetëm 3 kamionë në teren dhe nuk është tu u krye shërbimi si duhet, dhe 7 kamionë të tjerë i keni defekt? Pse kamionin MAN e qoni në kompaninë në Ferizaj me rregullua edhe e ktheni apër defekt? Pse kamionin e qoni në firmën Bosh në Mitrovicë të prishtë e qoni të prishtë e merrni? 8. Pse nuk po e zhvendoseni menaxhmentin e njësive në objektin e ri, e po paguni qira pa arsyeje? Këtu ka më shumë keq menaxhim nga regjioni apo njësia në Skenderaj dhe vini kërkon rritjen e tarifës, me pretekstin për rritje të pagave e performancës e menaxhmentit është për të ardhur keq, deri sa ju jeni duke menaxhuar këtë kompani. Është për të ardhur keq ku një Ushtrues detyre i Kryeshefit të kompanisë KRM Uniteti Sh.A pas gati tri viteve e sjellë një raport me katër faqe për të vetmin qëllim, që të kërkoj ngritjen e tarifës për mbeturina nga 5 € në 6 € për Amvisëri në grupi asamblistëve IDEL- it jemi kundërt shtrenjtimit të tarifës për mbeturina mbi 20% për ekonominë familjare pasi që kjo kompani është duke u keq menaxhuar. Në raportin që ju e keni sjellë në kuvend nuk është i kompletuar si duhet, pasi që pozita e menaxhmentit nuk i keni treguar se janë pagat, por si duket në këtë raport e keni bërë me qëllim që këtij kuvendi të mos i tregojnë se i keni

dy menaxhere te njësisë edhe një zëvendës menaxher, me siguri këta persona kane paga marramendëse, pasi që ju vete i keni mshefe ne këtë raport. Ku dihet se numër i ekonomive qe janë ne shërbim është mbi 6,500 ekonomi familjare, numër i bizneseve është mbi 500 biznese dhe mbi 70 institucione komunale, këto ekonomi dhe institucione kompanisë Uniteti njësisë ne Skenderaj i sjellin te hyra mbi 450,000€ në vit. Një kompani që ka 50 punëtorë dhe qe ka një buxhet prej 450,000 euro ne vit dhe prape kërkon rritje te taksës ishte absurditet i lloji te vete. Duke marre për baze se ne këtë ndërmarrje veç ne njësinë ne Skenderaj janë dy menaxher dhe një zëvendës menaxher, çka është edhe me skandaloze për këtë raport, nuk keni marr guximin me sjell raportin e auditorit te jashtëm për vitin 2023-2024.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Ylber Murtezaj: Sa i përket auditimit na i kemi auditorët shtetëror që është viti i 7, për çdo vite na auditojnë në detaje për çdo çështje dhe e bëjnë publike. Sa i përket kamionëve ju e dini së tre kamion janë në gjendje të mirë edhe me të ri, dhe kamionët tjerë janë me të vjetër dhe po kanë prishje teknike me të shpeshtë. Dhe mekaniket që janë të zoti nuk vinë me punua në garuzhdën tonë për 400€, dhe ata kamion duhet me i dërgua përmes kontraktorve me i rregullua. Dhe mekaniket që i kemi na janë vetëm me ja ndërrua ndonjë pjesë, e jo diçka ne elektrik. Sa i përket atë që po e thua për Shaip Dibrani nuk është e vërtetë hiq, sepse deri në vitin 2020-21, Shaipi ka qenë sigurim në njësi, personalisht duke e ditur gjendjen e tij që i ka ndodhur me herët e kanë marrë dhe e kemi bënë ndihmës elektrikistë dhe paga e ti prej 230€, ka kaluar në 328€, në vitin 2023, bordi i drejtorëve ka marrë një vendim që në mënyrë lineare të ngritën nga 100€ gjithë punëtorëve të vozitësve, punëtorëve fizik dhe sigurimit, ndërsa ja ka lanë në dorë kryesefit ekzekutive që të bëjë ngritjen deri 100€ në bazë të performancës dhe rezultatit në punë për gjithë kryepunëtorët të garuzhdave dhe kryepunëtorët në këtë raste ka përfitua edhe Shaipi që vendimin e kamë këtu që paga e tij është ngritur nga 328€ në 368€, dhe pozita e ti është ndihmës elektrikistë dhe pozita e elektrikistit ju ka rritë paga 400€.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Hysni Mehani-LVV: Nuk e kemi thirrë u.d e kryshefit me raportua për shpenzimet për të kaluarën, po e kemi thirrë me na arsyetua kërkesën për rritjen e tarifës, edhe ky e ka sjellë një raporte që na arsyeton të kaluarën. Dhe shumë ish kanë e rëndësishme me na tregua së ku keni me adresua rritjen, dhe çka keni me bë me këtë rritje? Unë po e shohë së dallimi ndërmjet inkasimit dhe faturimit është 40mijë€, d.m.th. 40mijë€ i keni humb, ndoshta ish kanë dashtë para se ti kërkonin rritjen me u fokusua, përse nuk po ndodh inkasimi, përse po i lejoni me humbë këto 40mijë€, pra cili është hapi për me rritë inkasimin? Edhe përse po paguani qira, a ka mundësi mos me pagua qira, masi është objekti? Edhe the mekanirit janë shume të vjetra dhe në ndërkohe, the që mekanikët nuk dinë me i ndreq se the janë shume elektronik që po bie kontradiktë. Dhe të shërbimi nuk mendoj që është e saktë nga kompania qysh po e paraqesin veç nëse ka dikush tendenca.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Ylber Murtezaj: Sa i përket tabelës që e kam paraqitë zërat financiar e kam paraqitë qëllimisht së ajo të jep me kuptua së njësia në Skenderaj për momenti është duke operua me humbje, prandaj kërkesa për ngritjen behet në dy drejtime, për me i zbutë këto humbje që po krijohen, por edhe për ngritjen e pagave për punëtorët e operatives, e jo për zyrtaret administrativ. Sa i përket zyrës që e kemi me qira, ne nuk kemi qare pa nejt në këtë zyre, sepse objekti që ti po fletë ende nuk ka rrym elektrike, garazhda është jofunksionale, dhe jemi të detyruar me nejtë në këtë zyre me qira për pagesën e qytetarëve.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Afrim Kabashi-NSD: Drejtor, sa është koeficienti i numrit të konsumatorëve dhe numrit të punësuarve, sa është me ligje dhe a është në përputhje me zyrën e rregullatorit për mbeturina? -A keni mundësi të na raportoni për përqindjen e hyrave, sa shkojnë nga të hyrat në paga punëtorëve të ndërmarrjes? -A ka pas investime kapitale nga të hyra vetjake?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Ylber Murtezaj: Së cili punëtor është i obliguar me vesh uniformen kur del në punë, mos veshja e uniformes është çështje e kryepunëtorit, dhe pse punëtorët janë të obliguar me vesh uniformen., edhe inspektorati na dënon si kompani në qoftë së punëtorët nuk e veshin uniformen. Në njësinë në Skenderaj janë të punësuar 51 punëtor, 8 në administrata, 1 furnizues, 4 inkasant, 3 mekanik, 1 mbikëqyrës të punëtorëve, 10 vozitës, 21 punëtor fizik dhe 3 rojë. Shpenzime për paga janë 307,091.62€, Shpenzime për derivate 80,221.54€, prej 442,704.62€ të inkazuara prej gjitha të hyrave 307,091.62€ shkojnë vetëm për paga.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Mentor Mehmeti-PDK: Fjala përshëndetëse, mua po me intereson, inkasimi-humbja që bëhet nga faturimi a bëhet me përmbarues, nëse bëhen përmes përmbaruesit besoj që nuk ka edhe humbje, edhe pse kam qenë 50 me 50 qytetarin dhe kompaninë, po e shohë që punëtorët kanë nevojë për përkrahjes, edhe pse nuk është një rritje shume e madhe edhe duhet me i ndihmua punëtorit edhe ka me kanë një rritje e pagave sipas ligjit që e lejon. Edhe pse në qytet nuk është i keq shërbimi, neper fshatra po ka ankesa, edhe pse unë e shohë punëtorin e këtij sektori si inxhinier të pastrimit e jo si pastrues.

Besart Rrecaj-PDK: Fjala përshëndetëse, unë desha me i ngrit dy çështje, a ekziston mundësia me pas një bashkëpunim me komunën së zyrën që e keni me qira me ja ofrua një hapësirë ne ndonjë zyre, që komuna me ja tërhiq qiranë? Edhe a keni bashkëpunime me ndonjë ambassade apo zyre të BE-së, se me sa di për politikat e gjelbërta ata financojnë projekte, si; dhurojnë kamion, ndonjë fabrikë për djegien e mbeturinave e kështu të ngjashme?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Ylber Murtezaj: Ne kemi bashkëpunim me Gizin gjerman dhe gjitha komunat kanë përfituar grande, dhe komuna e Skenderajt ka përfitua grande për performanc ne menaxhim të mbeturinave, dhe prej që jam në këtë pozitë nuk kam bërë kërkesë ende për grande.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: Fjala përshëndetëse, është përgjithësi e jona e përbashkët që kësaj kompanie me i ndihmua, sepse një njësi me operua me humbje, dhe nuk ka shanse me investua në pajisje të reja, dhe ofron shërbime. Asnjëherë nuk kemi pas kërkes për ndonjë zyre nga ana e kompanisë në drejtim të komunës sepse komuna ka zyre, dhe jam për me i ndihmua kësaj kompanie, dhe pres ndonjë kërkesë nga ana e saj. Edhe ju kisha lute mos te përmenden emrat e perveqshme, dhe uroj që kjo ngritje të ndikoj pak edhe ne ndërgjegjshmerin e një pjese të qytetarëve në kuptimin e mirëmbajtjes të ambientit, ju ftoj me përkrah këtë ngitje.

Kryesuesja: Dikush tjetër, nëse nuk ka, shkojmë në votim, Konstatojmë me (16) vota për, (8) kundër dhe (3) abstenim, miratohet Propozim-vendim për ngritjen e tarifës së shërbimit për grumbullimin e mbeturinave të ofruara nga KRM, "UNITETI", Sh.A. Mitrovicë, (Ndryshimin dhe plotësimin e nenit 18 paragrafi 1.1 shtojca A, të Rregullores Nr.01-110/04-0005958/23, të datës 31.01.2023 për Menaxhimin e Mbeturinave të Komunës se Skenderajt), me Nr.02-352/01-0010872/25, të datës 24.03.2025.

Vazhdojmë me piken 7 të rendi të ditës:

Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme, fjalën ja kaloj,

Afrim Kabashi-NSD: Pyetje, 1. Për Drejtorin e Gjeodezisë dhe drejtorisë për Urbanizëm: Cilat janë arsyet që disa rrugë të emërtuara në qytet, nuk janë të përfshira në aplikacionin google maps? 2. Për Drejtorin Urbanizmit; Drejtor kurë parashihni ti rifilloni punimet e mbetura gjysmë për banorët e fshatit Polac, si projekti i ndriçimit publik, projekti i rreth rrotullimit në disa vende kyqe, projekti për trajtimin e ujërave të zeza, si dhe projekti i mbetur gjysmë asfaltimit të disa rrugëve në disa lagje? 3. Për Drejtorin e Bujqësisë; Drejtor a ka mundësi të njoftohemi deri ku ka arrit të realizuar projekti me mjetet e ndara nga ky kuvend në përkrahje për fermerin Misim Shabani nga fshati Dashefc?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj: Afrim sa i përket emërimit të rrugëve janë bajagi do rrugë në qytet të cilët nuk kanë emërtim dhe para disa muajve e kemi aprovua listën rezerve dhe tash jemi duke u marr për së cilën rrugë dhe se cilën emërtim, sepse janë disa procedura. Sa i përket projekteve për rreth rrotullim i kemi dërgua disa kërkesa në ministri, pasi që ato rrugë janë në kuadër të ministrisë dhe janë aprovua disa rreth rrotullime, po punë nuk ka. Sa i përket kanalizimeve jemi tu punua në Qubrel, pastaj po shpeshojmë se do të dalim të xhamia, po ka shumë probleme asajde, edhe kanalizimet nuk janë për thasë të cementit as të grurit as për armatura që këto probleme po i kemi neper shumë fshatra. Sa i përket rrugëve i kemi në projekt është kontrata e nënshkruar ti shohim mundësit buxhetore, a po na jetë ndonjë buxhet me i trajtua apo po na shkojnë me përmbaues.

Drejtori i DBPZHR-së, Behxhet Maliqi: Fjala përshëndetëse, fermerin Misim Shabani nga fshati Dashefc, mjetet që ja kënaq nda aj me ato mjete i ka fillua punimet, po i ka ndalua për shkak të problemeve familjare që i ka pas, nuk ka arritë ti finalizoj punimet, jam jashtëzakonisht interesuar me i ndihmua këtij fermeri po gjatë kësaj vere ka me përfundua projekti.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Abdulla Gashi-IDEAL: Pyetje për drejtor, z. Driton Mula, Kam një kërkesë nga banorët e fshatit Kopiliq, të cilët më kanë lutur që ta ngrisë një çështje që i shqetëson prej kohësh. Bëhet fjalë për rrugën "Fatmir Sahiti", e cila ka një gjatësi prej rreth 300 metrash dhe ndodhet në gjendje shumë të keqe. Rruga është e mbushur me gropa dhe është shumë e vështirë për qarkullim, veçanërisht për automjete. Pyetje drejtuar Drejtorit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, z. Shahin Tahiri: I nderuar drejtor, a keni mundësi të përgjigjeni lidhur me një rast të dyshuar për keqpërdorim në QKMF? Bazuar në informacionet që kemi, dyshohet se ka pasur keqpërdorim të derivateve. A është bërë ndonjë kërkesë nga ana juaj për ta adresuar këtë rast në Komisionin Disiplinor? Pyetje për Kryetarin e Komunës së Skenderajt, z. Fadil Nura: Çka është duke u bërë me parkun e qytetit "Idriz Rreci"? A ka ndonjë projekt konkret për mirëmbajtje apo zhvillim të mëtejshëm të tij? -Çfarë keni në plan të ndërmerri lidhur me fabrikën e betonit në Polacë, e cila është kthyer në shqetësim për banorët e asaj zone? -Kur parashihet të përurohet tregu i gjelbër në Skenderaj? A mund të ndani ndonjë datë të saktë ose afat të planifikuar? -Kur pritet të fillojnë punimet në liqenin e fshatit Polac dhe cilat janë planet tuaja për zhvillimin e kësaj zone?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj: Abdulla nuk është bash keq ajo rrugë qysh po e banë ti, ajo rrugë është a kaluar, nuk është në gjendje të mirë, të shohim mundem me trajtua me zhavorr, po me asfalt ka me kanë problem.

Drejtori i DSHMS-së, Shahin Tahiri: Fjala përshëndetëse, sa i përket atë rasti në QKMF, për punëtorin, drejtori përgjegjës e ka dërgua në komisionin disiplinor.

Kryetari i komunës, Fadil Nura: Në parkun e qytetit është tu u realizua Muzeu i qytetit, është ndaluar për shkak të kohës, po shumë shpejt ka me vazhdua, Mirëmbajtja e parkut të qytetit behet

nga kompania eko-natyra. E kemi një projekt në procedurë për ujitjen dhe rregullimin e lojave vandalizëm që nuk prishen. Fabrika e betonit në Polac nuk jam përgjegjës, aj i ka kaluar afatet i kam bërë shkresë po presim edhe pak, edhe ligji e parashoh, ja shkëputem kontratën, dhe sipas komunikimit që kemi pritet me vazhdua. Tregu i gjelbër i qytetit është gati në fazën përfundimtare e kam si ide me ja dhënë në menaxhim eko-natyres që të mirëmbaj dhe ti merr taksat. Liqeri nuk është premtim i imi, u kanë projekt ide që është prezantua, unë e kam programin, e shkruar që është publik, që aj liqen nuk është premtim i imi, po ka qenë si propozim ide, dhe asnjëherë atë liqen nuk e kam premtua.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Musa Fazliu-IDEAL: Pyetje për kryetarin: 1.A ka mundësi që të rregullohet një rrugë për këmbësorë për nderime tek varret e 6 martirëve të fshatit Klinë e Poshtme të familjes Musliu që ndodhen të varrosur në hyrje të varrezave të fshatit Klinë e Epërme ku të 6 janë zënë rrobë dhe janë pushkatuar vlen të theksohet se njëri nga ta, Musli Musliu ka qenë edhe me parë i mbijetuar nga pushkatimi në masakrën e Izbices, ku në këtë masakër nga kjo familje janë të pushkatuar edhe 5 vete, Haliti, Ilazi, Beqiri, Muhameti, Naimi dhe Brahimi në vitin 1998 në fshatin tone?

2.Kur do të përfundojë ndriçimi në lagjet e fshatit Klinë e Poshtme sepse disa rrugë neper disa lagje kanë përfunduar e kemi kërkesa nga banoret për rrugët neper disa lagje si p.sh. Rr.Fatime Aliu, Rr.Sevdi dhe Selami Musliu, Rr.Sejdi Sejdiu, Rr.Miftar Bajrami dhe një pjesë e rrugës Rexhep Tahiri?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Kryetari i komunës, Fadil Nura: Musa, janë grupet në teren tu punua për ndriçim, dhe janë në projekt gjitha fshatrat ku ka shtylla të betonit të KEDS-it. Për pjesën për këmbësor janë disa pjesë aty pa punua kur të vim aty i rrinë gati e vazhdojmë edhe atë pjesë.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Liridona Koci-PDK: Për Drejtorinë e Urbanizmit, 1. I nderuar drejtor, punimet për trajtimin e ujërave të zeza në F.Polac, kur pritet të vazhdojnë, një proces ky i tejzgatur?

2.Rrugët e trasuara kohë më parë në Polac, por edhe pjesët tjera ku ka nevojë, kur pritet të asfaltohen? Për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, 1. Kur pritet të përfundojë ndriçimi në F.Polac? Një pjesë veçse ka përfunduar, kanë mbetur edhe pjesa tjetër që përfshinë lagjen: Koca, Gruda, Ngucati, Aliuka.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj: Liridona jemi tu punua në Qubrel, si të përfundojmë jemi të xhamia në Polac, po janë do probleme të vëlqit, të kabasht, të shohim si është mundësia.

Drejtori i DSHP-së, Alban Shala: Fjala përshëndetëse, projekti i ndriçimit publik është tu u zhvilluar, është projekt 3 vjeçar, është kontratë kornizë dhe punimet nuk besoj që kanë më përfundua gjitha fshatrat në këtë vite sepse është një pjesë e buxhetit edhe për vitin e ardhshëm.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Kushtrim Dragaj-PDK: Pyetje për drejtorinë e arsimit: 1.Drejtor, çfarë do të behët me gjysmën e shkollës së mesme në Runik e cila gjysma po behët çerdhe. A do të rinovohet gjysma tjetër? Drejtor, i kam pranuar disa ankesa nga disa prindër rreth xhamave të palestres të cilët tash e disa kohe janë të thyer dhe ka mundësi me u lëndua ndonjë nxënës. A kishit mund me intervenua në ndërrimi i tyre? Pyetje për drejtorinë e shërbimeve publike: 1.Kur pritet të fillojë ndriçimi në Bashkësinë Lokale të Runikut? A keni planifikuar të vendosen vendprirje në stacione të autobusëve në stacionet kryesore në Bashkësinë Lokale të Runikut? 2.Në seancën e kaluar e keni përmendur që do të filloni me largimin e deponive të mbeturinave. Banorët e lagjes Të xhamia në Runik kanë kërkuar largimin e mbeturinave në vendin e destinuar për treg pas xhamisë. Të cekura me foto.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtori i DSHP-së, Alban Shala: Kushtrim do të mundohem sa ma shpejt me bë ndriçimin në BL të Runikut në atë pjesë, po mendoj nga muaj qershor me startua asajde. Sa i përket deponive ilegale për heqjen e tyre startojmë javën e ardhshme. Sa i përket stacionit për ndalës të autobusëve në BL Runikut me konsultim me drejtorin e urbanizmit për shkak të realizimit të projektit të subqendres në Runik e ka marr si realizim drejtori i urbanizmit deri në përfundim të projektit.

Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj: Sa i përket adaptimit të shkollës në çerdhe një projekt e kemi bë si komunë me ministrin, po ka telashe shume, si kulmi, dyert janë të plastikes, të cilat nuk lejohen, kulmin e kanë marr përsipër ministria me përfundua komplet, të shohim.

Kryesuesja: Me kaq mbyllet kjo mbledhje, shihemi në mbledhjen tjetër.

Procesmbajtësi

Kryesuesja e Kuvendit





REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL / ASSEMBLY OF MUNICIPALITY / SKUPSTINA OPŠTINE
SKENDERAJ



Nr. 02-400/09-0017493/25
Data 13.05.2025

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Skenderaj
Skupština Opštine Skenderaj
Skenderaj Municipal Assembly

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

DATE/A:	13.05.2025
PËR/ZA/TO:	Kryesuesen e Kuvendit Komunal, z. Adelina Spahiu
Cc:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Kryetarit të Komunës z. Fadil Nura
NGA/OD/FROM:	Drejtori për Buxhet dhe F. z. Ismet Alin
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim vendim për bartjen e mijetëve të pashpenzuara të hyrave vetanake nga viti 2024 për shpenzim në vitin 2025.

Të nderuar/a,

Duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 2 dhe nenin 9 paragrafi 7 i Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, përmes këtij propozim vendimi kërkohet aprovimi i juaj për bartjen e të hyrave vetanake komunale të pashpenzuara nga viti 2024 në vitin 2025 në shumën prej **194,930.63 €** dhe këto të hyra të jenë në dispozicion për financim të shpenzimeve kapitale:

Të bartën në kategoritë:

Në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime shuma prej 92,002.99 €

Në nën programin Shërbimet e shëndetësisë primare 74400 kodi funksional 0721 shuma 40,000 €,

Në nën-programin Arsimi parashkollor 92650, kodi funksional 0911 shuma prej 30,000.00 €.

Në nën-programin Infrastruktura rrugore 18023, kodi funksional 0451 shuma prej 22,002.99 €

Në kategorinë ekonomike Subvencione dhe transferove shuma prej 30,000.00 €

Në nën-programin Planifik. i Zhvillimit Ekonomik 48023 kodi funksional 0411 shuma 30,000.00 €

Në kategorinë e shpenzimeve kapitale shuma prej 72,927.64 €

Në nën-programin Planifikimi mjedisor dhe inspekcioni 66620, kodi funksional 0620 projektin si vijon :

“Vazhdimi i punimeve të kompleksi i UÇK-së - Objekti i U-së” kodi i projektit 52641 shuma 72,927.64 €

Arsyetimi:

Kategoria mallra dhe shërbime: bartja e mjeteve ne këtë kategori është me se e domosdoshme për shkak te obligimeve te cilat janë ne vazhdimësi sidomos te sigurimi i barnave esenciale, shërbimet e nevojshme ne zonat rurale, arsimi para fillor te i cili janë furnizimet për fëmijët parashkollor me artikuj te nevojshëm, furnizimet për material higjenik ne arsimin fillor, shërbime tjera te kontraktuara nga shërbimet publike, Te gjitha programet janë reduktuar nga këto vendime me çka është rrezikuar edhe mbulimi i shpenzimeve operative me buxhetin e vitit 2025.

Kategoria e subvencioneve dhe transferove: realizimi i vendimit të Asamblesë Komunale i datës 03.03.2025 me nr. 01-400/01-0008611/25 për mbështetje financiare te “Eko Natyra” SH.A. Skenderaj” për ngritjen e kapaciteteve dhe zgjerimin e shërbimeve.

Kategoria shpenzimeve kapitale: bartja e mjeteve për projektin e lartcekur ne programin përkatës është obligim sipas kontratës dhe anekse kontratës dhe me këtë bartje te mjeteve përfundon edhe realizimi i këtij projekti.

Pytje per Drejtorin e Inspektoriatit

1.A ka mundësi qe të bëhet kërkes nga ju per vendosjen e semaforave ose nje rreth rrotulimi ne rrugën Tal Sherif Miftari ne hyrje të fshatit Klinë e Poshtme sepse po ndodhin shumë aksidente e se fundi kemi edhe aksident me fatalitet.

Pytje per Drejtorin e Urbanizmit

2.A ka mundësi qe te vendosen pusetat ne gypat e kanalizimit në mes të Klinës se Mesme dhe Klinës se Poshtme dhe tjetra puset e cila gjindet ne një degëzim, ku si pasoje e mos vendosjes se ketyre pusetave egziston mundësia qe te bllokohen mbi 2 km.

Skenderaj

07.05.2025

Musa Fazliu

Pyetjet dhe kërkesat e anëtareve për ekzekutivin e Komunës, Maj 2025

1. **Për Drejtorin për Administratë, Hamit Geci:** a) Pse behet pagesa prej 50€ për regjistrimin e vdekjes. A është me ligje i përcaktuar prej pas luftime, a vlen ky ligj nga viti 2015 apo para vitit 2015, Dhe a është ky ligj vetëm në komunën tonë apo është në fuqi në tere Kosovën?
b) Tani jemi në Pragë të pushimeve verore, e mërgimtarët vijnë në pushime, ku shumica prej tyre kërkojnë shërbime administrative e konkretisht nga gjendja civile për të u pajisur me dokumente e tyre personale, A jeni të përgatitur për fluksin e tyre, apo keni ndonjë sportel të veçantë për kërkesat e tyre në gjendjen civile?
2. **Për Drejtorin e Urbanizmit, Driton Mula:** Drejtor a parashihni për vazhdimin e punimeve në projektin për trajtimin e ujërave te zeza në fshatin Dashefc, konkretisht tek lagjet Beqiri dhe Rexhepi?
3. **Për Drejtorin për Arsim, Kastriot Duraku:** Drejtor interesimi i banoreve te fshatit Polac është lidhur me projektin e paralajmëruar dhe mjaftë te përfolur me herët lidhur me çerdhen e fëmijëve, A kemi ndonjë informatë nga ana e juaj, a pritët të realizohet ky projekt mjaft i rëndësishëm, apo ku është problemi i mos realizimit?

Afrim Kabashi - NSD-së

Pyetje për Drejtorin e DKA-së, z. Kastriot Dutaku- I nderuar Drejtor, Ju lutemi, a mund të na përgjigjeni në pyetjen në vijim: Me cilat kritere e keni bërë emërimin e zëvendës-drejtoreshës në shkollën e re fillore në Skenderaj, znj. Rreszarta Hasani-Ibrahimi?

Pyetje për Kryetarin e Komunës së Skenderajt, z.Fadil Nura: Z. Kryetar, A mund të na informoni se sa i keni përkrahur shoqatat e dala nga lufta në komunën e Skenderajt gjatë viteve 2023 dhe 2024? Konkretisht, cilat shoqata janë mbështetur dhe në çfarë forme është realizuar kjo përkrahje (financiare, logjistike, përmes projekteve të veçanta, etj.

I nderuar Kryetar, Shoqata e Pensionistëve të TMK-së dhe FSK-së “ELITA”, dega në Skenderaj, ka paraqitur disa herë kërkesa për sigurimin e një zyre për punë, por deri më tani nuk ka marrë asnjë përgjigje zyrtare nga Komuna.

A mund të na informoni nëse Komuna ka në plan të ndajë një hapësirë zyrtare për këtë shoqatë dhe kur mund të pritët një vendim apo përgjigje konkrete në lidhje me këtë çështje?

Pyetje për Drejtor e urbanizmit z.Driton Mula: Kemi një pyetje në lidhje me projektet infrastrukturore në zonën tonë. A keni mundësi të na informoni nëse ka një datë të saktë se kur pritët të fillojë projekti i ujit në fshatrat Kryshec dhe Marine?

Gjithashtu, a ekziston ndonjë projekt i paraparë për kanalizimin në lagjen Kuqica të fshatit Marine? Çdo informacion do të ishte shumë i mirëpritur për ne si banorë të zonës.

Abdulla Gashi-IDEAL